

Tiranë, më 27.08.2018

VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
"PRIMA INVESTMENT" sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 27 / 08 / 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), ditën e hënë, ora 10 : 00, u mbledh rregullisht në selinë e shoqërisë dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm të shoqërisë "**Prima Investment**" sh.p.k, shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar. I pranishëm në mbledhje është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili përfaqëson 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë:

Besmir Kodra, i biri i Lulzim, i datëlindjes 02.03.1986, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr. Personal I60302052P, madhor dhe me zotësi të plote juridike për te vepruar.

Asambleja e Ortakut të vetëm të Shoqërisë "**Prima Investment**" sh.p.k, shqyrtoi temën e mëposhtme të rendit të ditës:

Shtimin e kapitalit të shoqërisë "**Prima Investment**" sh.p.k me kontributin në natyrë me vlerë 28.350.000 (njëzetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, llogaritur sipas aktit të Rivlerësimit të Pasurisë së Paluajtshme, më datë 12.04.2017, e paraqitur si pasuria e paluajtshme me nr. 8/576 e ndodhur në Zonen Kadastrale 8220 me sip. 79 m², vol. 23, fq 191 me adrese në Rr: "Stavri Themeli".

Në përfundim, pas shqyrtimit të rendit të ditës, mbështetur në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar dhe ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, asambleja e ortakut të vetëm të shoqërisë,

VENDOSI

1. Të miratojë shtimin e kapitalit të shoqërisë "**Prima Investment**" sh.p.k. me kontributin në natyrë me vlerë 28.350.000 (njëzetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, llogaritur sipas aktit të Rivlerësimit të Pasurisë së Paluajtshme, më datë 12.04.2017, e paraqitur si pasuria e paluajtshme me nr. 8/576 e ndodhur në Zonen Kadastrale 8220 me sip. 79 m², vol. 23, fq 191 me adrese në Rr: "Stavri Themeli".

2. Autorizohet Znj. Pranvera Komici me nr. Personal J25314016R dhe zt. Kreshnik Ahmeti me nr. Personal I70914078S, për depozitimin e këtij vendimi pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Pas përfundimit të temave të rendit të ditës drejtuesi shpalli mbylljen e mbledhjes.

Ky akt lexohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë "**Prima Investment**" sh.p.k. i cili pranon përmbajtjen e tij, duke shprehur vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm
Shoqëria "PRIMA INVESTMENT" sh.p.k.
Ortaku i vetëm i Shoqërisë

Besmir KODRA

